



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 34

Prishtinë, më 30.7.2015, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvie Halimi, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Agim Aliu, Armend Zemaj, Doruntinë Maloku, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi dhe Milena Miliçeviq

Mungoi: Fatmir Limaj.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hamit Mjeku dhe Zahir Çerkini - praktikantë.

Nga Stafi i Komisionit: Hana Bajraktari.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funksional në projektligjin nr. 05/L-040, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në projektligjin nr. 05/L-040, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-026 për Markat Tregtare;

Albulena Haxiu, kryetare, tha se ne e kemi marrë raportin me amendamente të Komisionit për Zhvillim Ekonomik dhe kam vërejt se me amendamentin 6, është ndërhyrë në ligjin bazik e që bie ndesh me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Amendamentet tjera nuk ka ndonjë pengesë për procedim dhe lidhur me këtë kërkoi edhe mendimin e anëtarëve tjerë të komisionit.

Selviqe Halimi, tha se duhet pasur kujdes sepse nganjëherë propozohen amendamente në ligjin bazik por që me dispozita të Projektligjit është bërë një ndarje apo ndryshim, me qëllim të qartësimit të dispozitave të Projektligjit. Andaj në këtë kontekst ne nuk e kemi shumë të qartë se sa është ndërhyrë në ligjin bazik. Ky është vetëm si shqetësim përndryshe nuk kam ndonjë vërejtje rreth procedimit të Projektligjit.

Pas diskutimeve, Komisioni, në mënyrë unanime vendosi që Kuvendit dhe Komisionit FunkSIONAL t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Projektligji nr. 05/L-040 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-026 për Markat Tregtare dhe amendamentet e propozuara, janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm;
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim;
3. Komisioni paraqiti vërejtjet se me amendamentin 6 është ndërhyrë në Ligjin bazik.

3. Të ndryshme.

Në këtë pik nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu